



Unioni i Turizmit të
Kosovës
Tourism Union of
Kosova

KOMUNA VUSHTRRI

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

E lidhur ndërmjet:

- Komunës së Vushtrrisë Adresa: Sheshi "Ahmet Krasniqi" nr.10, 42000, Vushtrri, përfaqësuar nga **z. Ferit Idrizi**- Kryetar i Komunës së Vushtrrisë

dhe
 - Unionit të Turizmit të Kosovës, Adresa: Rr. Pashko Vasa nr.54, 10000 Prishtinë, Përfaqësuar nga **z. Baki Hoti** – Kryetar i Unionit të Turizmit të Kosovës.
-

Neni 1 Qëllimi

Qëllimi i kësaj marrëveshje është krijimi i marrëdhënieve të bashkëpunimit në mes të Komunës së Vushtrrisë dhe Unionit të Turizmit të Kosovës në përmirësimin e gjendjes në sektorin e Turizmit në Komunën e Vushtrrisë.

Neni 2 Dakordimi i palëve

Palët e kësaj marrëveshjeje dakordohen në koordinimin dhe bashkëpunimin e aktiviteteve të ndërsjellta, si në hartimin e politikave, strategjive zhvillimore dhe aktiviteteve turistike.

Neni 3 **Aktivitetet e Planifikuara**

1. Palët dakordohen në koordinimin e aktiviteteve dhe integrimin në planet vjetore të tyre, specifikisht, në fushat e:

- 1.1. Koordinimit të akterëve të Turizmit në Vushtri;
- 1.2. Zhvillimit dhe promovimit të Turizmit të Qëndrueshëm, atij Kulturor, Turizmit Rural, Agroturizmit etj.
- 1.3. Përmirësimit të politikave dhe strategjive zhvillimore në sektorin e Turizmit për Komunën e Vushtrrisë,
- 1.4. Bashkëpunimi në përpilimin e materialeve promovuese të Turizmit (broshura, video etj.),
- 1.5. Krijimin e mundësive për vendosjen e bizneseve të Vushtrrisë në aplikacionin Think Kosova,
- 1.6. Bashkëpunimi në përfshirjen e Vushtrrisë në sa më shumë paketa turistike të cilat do të përpilohen nga Touroperatorët.
- 1.7. Mundësia e pjesëmarrjes në Panaire Vendore dhe Ndërkombëtare të Turizmit me qëllim promovimin.

Neni 4 **Koordinimi dhe konsultimi**

1. Palët do të inkurajojnë bashkëpunimin e shkëmbimit të të dhënave turistike si dhe praktikave të mira profesionale.
2. Pjesëmarrësit gjithashtu do të takohen periodikisht për të shqyrtuar aktivitetet në fushën e turizmit, dhe për të shkëmbyer informacione të rëndësishme.
3. Çdo shqetësim në lidhje me interpretimin, administrimin ose zbatimin e kësaj Marrëveshjeje të Bashkëpunimit zgjidhet me anë të konsultimeve midis palëve.

Neni 5 **Kohëzgjatja**

Kjo Marrëveshje e Bashkëpunimit lidhet në afatë kohor prej 3 viteve nga dita e nënshkrimit me mundësi vazhdimi me dakordimin paraprak të palëve nënshkruese.

Neni 6 **Ndryshimet dhe ndërprerja e marrëveshjes**

1. Palët pajtohen që në rast nevoje marrëveshja mund të ndryshohet dhe plotësohet.
2. Palët do të përpiqen të zgjidhin çdo keqkuptim ose mosmarrëveshje të mundshme në lidhje me këtë marrëveshje në mënyrë miqësore.

3. Secila nga palët mund të ndërpresë pjesëmarrjen e saj në këtë Marrëveshje të Bashkëpunimit, duke dërguar një njoftim me shkrim tridhjetë (30) ditë më parë.

Neni 7
Hyrja në fuqi

Kjo marrëveshje dhe hyn në fuqi me nënshkrimin nga Palët.

Neni 8
Numri i ekzemplarëve

Marrëveshja është hartuar në dy (2) ekzemplarë identikë, nga një për secilën palë nënshkruese.


Vushtrri, më _____ 2023



Për Komunën e Vushtrrisë

Ferit Idrizi
Kryetar i Komunës

Për Unioni i Turizmit të Kosovës


Baki Hoti
Kryetar, UTK